

Gjykata e Qarkut të Pejës
P.nr.66/11

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Qarkut në Pejë, me trupin gjykues të përbërë nga gjykatësi Malcolm Simmons si Gjyqtar Kryesues dhe Gjyqtarët Riku Jaakkola dhe Shaban Shala, si anëtarë të trupit gjykues, si dhe Procesmajtëses së Gjykatës, Robina Struthers, në çështjen penale kundër Hakif Hamiti (më tej "pandehuri"), i akuzuar në bazë të Aktakuzës PP. numër 73/2001 të datës 5 Korrik 2001, me Zotërim të Paligjshëm të Një Saise Armësh në kundërshtim me Nenin 199, paragrafit 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të lexuar me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, pas mbajtjes së gjykimit publik, më 2 Mars 2011, në të cilin z. Peter Korneck u përfaqësoi Prokurorinë kurse z. Besnik Berisha përfaqësoi të pandehuri, i cili ishte i pranishëm, më 2 Mars 2011 mori dhe publikisht shpalli si në vijim, këtë

AKTGJYKIM

I pandehuri Hakif Hamiti, me numër të lëternjoftimit 1014829837, i lindur më 13 Shkurt 1943 në Sveqel, komuna e Podujevës, emri i babait, Shaban, emri i nënës, Shahe, shqiptar i Kosovës, i martuar, baba i tre fëmijëve, me status mesatar ekonomik, i shkolluar, i papunë, ka qëndruar në paraburgim nga data 10 Maj 2001 deri më 5 Shkurt 2002, është

FAJTOR

Sepse:

Më 10 Maj 2001, në vende të ndryshme, i përmenduri Hakif Hamiti është vënë re nga anëtarë të karabinierëve italianë, si pjesë e një grupi të organizuar që kontaktoi shoferin e kamionit MAN, numri i regjistrimit 816 M 690, me rimorkio me numër të regjistrimit 719 M 226 në një hapësirë parkimi përballë doganës së Pejës. I pandehuri në një Audi të përhimtë me targa 114 KS 030 pastaj i shkoi prapa kamionit posa u nis nga hapësira e parkimit në drejtim të Pejës, së bashku me dy makina të tjera. Të tri makinat dhe kamioni janë ndjekur dhe shoferët e tyre më pas janë ndaluar nga karabinierët përballë një shtëpie private në Pejë. Gjatë kontrollit të kamionit policët zbuluan një sasi të madhe të armëve, duke përfshirë edhe 52 raketa-hedhës anti-tank të prodhimit ish-jugosllav, 20 predha mortajash me siguresat rregullueshme për veprim të menjëhershëm apo të vonuar, një raketë anti-ajrore dhe paisje të tjera. Gjykata konstaton se gjatë gjithë kohës aktuale i pandehuri ishte në zotërim të armëve të cekura.

Prandaj,

I përmenduri, Hakif Hamiti, ka kryer veprën penale të Zotërim të Paligjshëm të Një Saise

Armësh sipas Nenit 199, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të lexuar me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë

Me të shpallur fajtor lidhur me veprat në fjalë:

Hakif Hamiti dënohet me burgim prej 271 ditësh.

Në bazë të Nenit 50 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të Nenit 351 të Ligjit të Procedurës Penale, koha e kaluar tashmë në paraburgim do të mirret në llogari.

Gjykata nuk lëshon urdhër për shpenzimet.

Sa i përket e veçorive rënduese, gjykata ka marrë parasysh sasinë e armëve të konfiskuara.

Në përcaktimin e një dënimi të përshtatshëm Gjykata ka marrë parasysh faktin se vepra ka ndodhur në vitin 2001, rolin e të Pandehurit në veprat penale, faktin se që nga vepra penale, i Pandehuri nuk ka qenë i akuzuar për ndonjë vepër tjetër penale. Më tej, Gjykata merr parasysh deri në maksimum peshën e pranimin të hershëm të fajësisë nga i Pandehuri.

Aktgjykimi përfundimtar mund të shpallet në media publike.

Gjykata do të lëshojë Aktgjykimin me shkrim brenda 15 ditësh.

Palët kanë të drejtë të ankohen kundër Aktgjykimit.

I pandehuri është i detyruar të njohtojë gjykatën për çdo ndryshim të adresës deri sa Aktgjykimi të bëhet i plotfuqishëm.

ARSYETIMI

A. Sfondi procedural

Një Aktakuzë është ngritur më 5 Korrik 2001 në Gjykatën e Qarkut në Pejë kundër Hakif Hamitit, Arsim Gashit, Mirsat Ibrahimit, Halim Krasniqit, Agron Hamitit, Gjezair Miftarit dhe Xheladin Gashit.

Aktakuza fillimisht përmbante tri arsye:

- *Zotërim të paligjshëm të një sasive të madhe të armëve në kundërshtim me Nenin 199 paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të lexuar me Nenin 8 dhe 19*

të Ligjit mbi Blerje, Posedim dhe mbajtje të Armëve dhe të Municionit Ligji Nr. 40 i 1980) dhe Nenit 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Hakif Hamiti, Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi, Halim Krasniqi, Agron Hamiti, Xhezair Miftari dhe Xheladin Gashi.

- *Legalizi të Përmbajtjes së Pavërtetë në Dokumenta Zyrtare* në kundërshtim me Nenin 205 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të lexuar me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Hakif Hamiti, Arsim Gashi, Mirsat Ibrahimimi, Halim Krasniqi, Agron Hamiti, Xhezair Miftari dhe Xheladin Gashi.

- *Zotërim të Paligjshëm të Armëve* në kundërshtim me Nenin 197, paragrafi 1 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, të lexuar me Nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë për të pandehurit Xhezair Miftari, Xheladin Gashi dhe Halim Krasniqi.

Shqyrtimi i parë kryesor ka filluar më 19 Dhjetor 2001 përballë një trupi gjykues ndërkombëtar dhe ka përfunduar më 6 Mars 2002. Në Aktgjykimin e saj, trupi gjykues vendosi të lirojë Agron Hamitin nga të gjitha akuzat. Më tej vendosi se të pandehurit Arsim Gashi, Mirsad Ibrahimimi, Halim Krasniqi dhe Xheladin Gashi ishin fajtorë për *Zotërim të Paligjshëm të Një Saise Armësh*, sipas Nenit 22 të KPJ dhe Nenit 199 paragrafi 1 dhe 3 të KPK-së, por i liroi nga *Legalizimi i Përmbajtjes së Pavërtete në Dokumenta Zyrtare*, në bashkëpunim, në kundërshtim të Nenit 205 të KPK-së të lexuar me Nenin 22 të KPJ dhe të veprës penale të *organizimit të një grupi, në bashkëpunim, për kryerjen e veprës penale të Zotërimit të Paligjshëm të Armëve* nga Neni 197 paragrafi 1 të KPK-së të lexuar me Nenin 22 të KPJ, meqe elementet e veprës penale ishin konsumuar në kuadër të Pikës Një.

Trupi gjykues kishte vendosur më parë që procedura kundër Xhezair Miftarit dhe Hakif Hamitit të ndahet nga të pandehurit e tjerë për shkak të gjendjes së tyre mjekësore.

Gjykata e Lartë me një aktvendim të datës 6 Mars 2005 vendosi të anulojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe e dërgoi çështjen në rigjykim. Ky aktvendim kishte të bënte vetëm me të pandehurit Mirsat Ibrahimimi, Arsim Gashi, Halim Krasniqi dhe Xheladin Gashi.

Në Dhjetor 2009, kryetari i Gjykatës së Qarkut në Pejë kërkoi nga kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it që gjyqtarët e EULEX-it të marrin përsipër këtë rast për shkak të pengesave procedurale. Rasti iu dorëzua gjyqtarëve të EULEX-it në Gjykatën e Qarkut në Pejë më 24 Shkurt 2010. Rasti kundër Mirsat Ibrahimit, Arsim Gashit, Halim Krasniqit dhe Xheladin Gashit u mbyll më 11 Nëntor 2010.

Më 22 Shkurt 2011, kryetari i trupit gjykues lëshoi një Urdhër në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Pejë të caktojë një numër të ri për rastin kundër Hakif Hamitit dhe të fshijë emrin e tij nga dosja e çështjes P.Nr. 143/05.

B. Shqyrtimi i dytë kryesor

Shqyrtimi kryesor ndaj Hakif Hamitit, u mbajt publikisht më 2 Mars 2011 në praninë e të Pandehurit, avokatit të tij mbrojtës, Besnik Berisha, dhe prokurorit të EULEX-it. Gjykimi u përmyll të njëjtën ditë. Prokurori i EULEX-it e potencoi vetëm Pika 1 (një) e aktaktakuzës origjinal mbetet ndaj të pandehurit.

Palët nuk shtruan asnjë kundërshtim në lidhje me juridiksionin e gjykatës e as lidhur me përbërjen e trupit gjykues.

I pandehuri u deklarua fajtor për veprën penale të posedimit të një sasive të madhe të armëve, pas konsultimit me avokatin e tij mbrojtës.

Përkthyesit ndërkombëtar përkthyen nga anglishtja në shqip dhe anasjelltas gjithë procedurën gjyqësore dhe dokumentet e gjykatës të rëndësishme për gjykimin.

C. Përmbledhje e provave

Gjatë shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues nuk ka dëgjuar asnjë dëshmitar, smeqë asnjë nuk u propozua nga ana e prokurorit publik ose të mbrojtjes. Prokurori publik iu referua provave të prokurorisë të pranishme në dosjen e çështjes.

Pasi ka shqyrtuar dosjen e çështjes, trupi gjykues errdhi përfundim se më 10 Maj 2001, i pandehuri, Hakif Hamiti, ishte pjesë e një grupi të organizuar që zhvilloi kontakt me shoferin e një kamioni MAN me numër të regjistrimit 816 M 690 me numrin të regjistrimit të rimorkios 719 M 226 në një zonë parkimi përballë Doganës së Pejës. Kjo rrjedh nga vëzhgimet e kryera nga oficerët karabinierisë italiane e në veçanti Mario Schiariti, i cili u ftua si dëshmitar në shqyrtimin e parë gjyqësor kundër Mirsat Ibrahimit, Arsim Gashit, Halim Krasniqit dhe Xheladin Gashit në vitin 2002. Karabinierët dyshuan se makina në fjalë ishte duke u përdorur për transportin e paligjshëm të armëve në vendkalimin kufitar të Kullës për këtë arsye monitoronin të gjitha maunet që kalonin nëpër zyrën doganore në Pejë.

Pas kësaj, i pandehuri Hakif Hamiti u vu re në një Audi të përhimtë me targa 114 KS 030, si pjesë e një karvani të tri makinave, të cilat e shoqëruan kamionin deri në një banesë private në Pejë.

Të tri makinat u përcollën dhe më pas u ndaluan për mbajtje nga karabinierët përballë një shtëpie private në Pejë. Gjatë kontrollit të kamionit, policët italian zbuluan një sasi të madhe të armëve të poshtë shënuara:

1. 52 raketa-hedhëse anti tank të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 44 mm, modeli "M-80";
2. 20 cilindra kartoni të zi që përmbanin mortaja të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 81/82 mm, modeli "M-69", me siguresa ët rregullimit për veprim të menjëhershëm apo të vonuar;
3. 4 cilindra kartoni të zi që përmbanin mortaja të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 81/82 mm, modeli "M-74", me siguresa të rregullimit për veprim të menjëhershëm apo të vonuar;

4. 1 cilindër të kartonit të zi që përmbante mortaja të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 81/82 mm, me siguresa të rregullimit në Bakelit për veprim të menjëhershëm pa numër serik;

5. 1 top pa drridhje të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 81/82 mm, modeli "M-61";

6. 10 cilindra kartoni të zi që përmbanin predha topi të prodhimit ish-Jugosllav të kalibrit 82 mm, modeli "M-60A";

7. 2 Arka të gjelbërta që përmbanin nr. 1 raketë anti tank të dirigjuar me tël, modeli AT-3 Sagger teli-udhëzuar, secili pa panel të kontrollit (konsolë);

8. 12 raketa-hedhës anti tanke, modeli "M-79", të kalibrit 90 mm, prej tyre 10 copë të kompletuara, 1 copë pajisje të shkrepjes dhe të vëzhgimit, 1 copë pa mbështetëse në shpatull, si dhe pajisje të shkrepjes dhe tëqitjes dhe vëzhgimit;

9. 12 -raketa-hedhëse anti tank të modelit "M-79", kalibër 90 mm;

10. 1 Mortajë të modelit "M-57", kalibri 60 mm, pa bazë mbështetëse;

11. 1 pajisje vëzhguese për Mortajën të modelit "M-57", kalibri 60 mm;

12. 1 Mortajë të modelit "M-69", kalibri 81/82 mm pa dykëmbësh, i pajisur me shtupë për pastrim;

13. 1 top pa drridhje të modelit "M-60A", kalibër 82 mm, të montuar mbi karrocë topi me rrota me shtupë për pastrim dhe pa pajisje për vëzhgim;

14. 4 raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14", të kalibrit 7 mm, nga ato vetëm 1 me pajisje të shkrepjes;

15. 7 bateri për një përdorim për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14", kalibri 75 mm pa numër serik;

16. 1 pajisje për shkrepje për raketa anti-ajrore portative të modelit "SA-14", kalibër 75 mm;

17. 1 raketë anti-ajrore portative të modelit "SA-16", kalibër 70 mm, pa pajisje shkrepjeje dhe bateri;

18. 2 pushkë automatike Zastava të modelit "M-84", kalibër 7,62 mm;

19. 1 kuti që përmbante një rrip me 98 predha për modelin Zastava "M-84" të kalibrit 7,62 mm;

20. 1 pushkë sulmuese Zastava e modelit "M70-A", kalibri 7,63 x 39 mm;

21. 4 magazina për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A", kalibri 7,63 x 39 mm;

22. 86 predha të ndryshme (gjurmë, të zakonshëm dhe plumba shpuese) për pushkë sulmi të modelit Zastava "M70-A", kalibri 7,63 x 39 mm;

23. 5 pushkë gjysëautomatike të modelit Zastava "M76-A", kalibri 7,9 mm, pajisje për vëzhgim preciz dhe magazinë;

24. 20 predha të kalibrit 7,9 mm pushkë gjysëm-automatike të modelit Zastava "M76-A";

Gjykata e konstaton se gjatë gjithë kohës aktuale i pandehuri, Hakif Hamiti, në bashkëpunim me të tjerët, ishte në zotërim të kësaj sasive të madhe të armëve.

Në marrjen e këtij Aktgjykimi, trupi gjykues shqyrtoi me kujdes provat e paraqitura në shqyrtimin kryesor si dhe ato që gjenden në dosjen e çështjes.

Ngjarjet në lidhje me këtë çështje të procedimeve penale kanë ndodhur në Maj 2001. Prokuroria është ballafaquar me vështirësi të dukshme në sjelljen e dëshmitarëve para gjyqit - duke përfshirë anëtarët e karabinierisë italiane, të cilët që atëherë kanë lënë Kosovës – të cilët mund të ndihmonin Gjykatës në vendosmërinë e pretendimeve të çështjes së Aktakuzës së ndryshuar. Më tej, kalimi e kohës në mënyrë të pashmangshme ka pasur një efekt negativ mbi cilësinë e provave dëshmuese.

D. Përcaktimi i dënimit.

Gjatë vendosjes për një dënim të përshtatshme për të pandehurin trupi gjykues ka marrë në konsideratë pranimin e fajësisë i pandehuri e ka bërë në fillim të shqyrtimit kryesor gjyqësor, se 10 vjet kanë kaluar që nga kryerja e veprës penale dhe se i pandehuri është një pjestar i integruar në shoqëri. Më tej, nuk ka të dhëna të regjistruara se i pandehuri ka kryer ndonjë vepër penale mëvonë.

Prandaj, trupi gjykues vendosi të shqiptojë dënim me burgim prej 271 ditësh. Koha tashmë e kaluar në paraburgim do të llogaritet në dënim sipas Nenit 50 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të Nenit 351 të Ligjit të Procedurës Penale.

E. Shpenzimet

Edhe pse i pandehuri është shpallur fajtor nga trupi gjykues, gjykata nuk do të lëshojë asnjë urdhër për shpenzimet për shkak të faktit se ky rast është përmbyllur shpejt dhe në mënyrë efikase si rezultat i pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit që në fillim.

Më datën 2 Mars 2011



Gjyqtari Riku Jaakola
Anëtar i trupit gjykues

Gjyqtari Shaban Shala
Anëtar i trupit gjykues

Robina Struthers
Procesmbajtëse

KËSHILLA JURIDIKE: Personat e autorizuar mund të parashetrojnë ankesë kundër një Aktgjykimi të shqiptuar me menjëherë brenda 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të dorëzohet me shkrim, sipas Nenit 359 të Ligjit mbi Procedurën Penale.